



RAPORT MONITORIMI JANAR – DHJETOR 2024

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022-2026

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024.....	8
III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS	10
➤ Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës	10
➤ Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës	11
➤ Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës.....	11
➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës	12
➤ Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës.....	12
IV. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE	18
V. NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024.....	33
VI. VLERËSIMI I SFIDAVE, HAPAT NË VIJIM	34

SHKURTIME

AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DM	Drejtësia për të Mitur
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur



KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PR	Parlamenti Rinor
SDM 2022-2026	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2022-2026
SIDhDPM	Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më maksimal të mundshëm. Kuadri ligjor synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjiteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të integritetit dhe dinjitetit.


Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026 dhe Plan i saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Dokumentet e saj strategjike përfshirë si, Plan i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan në me VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë.

Zbatimi i “SDM 2022-2026” është arritur përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për zbatimin e strategjisë është grupi ku diskutohen çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SDM 2022-2026” me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional me grupet e interesit. Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror, drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre. Ky rrjet mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

SDM 2022-2026 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj, 4 Qëllime Politike, 13 Objektiva Specifike dhe 64 masa për të kontribuar në performancën e 45 indikatorëve cilësorë dhe sasiorë.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Parë Politik për “Parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve” konstatohet se:



Referuar aktiviteteve kryesore janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të promovuar edukimin ligjor dhe të drejtat e fëmijëve. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka realizuar aktivitete edukative në shkolla për të informuar fëmijët mbi të drejtat e tyre dhe për të parandaluar veprat penale. Monitorime dhe anketa janë zhvilluar për të vlerësuar efektivitetin e programeve mësimore dhe për të përmirësuar klimën shkollore.

Një fokus i rëndësishëm ka qenë edhe sigurimi i mjedisit të sigurt online për fëmijët, përmes aktiviteteve ndërgjegjëse dhe trajnimeve, duke përfshirë punën me mësuesit dhe profesionistët për të promovuar përdorimin e sigurt të internetit. Gjithashtu, është punuar intensivisht për parandalimin e dhunës dhe abuzimeve online, ku janë organizuar shumë aktivitete për të informuar dhe ndihmuar fëmijët dhe profesionistët në këtë fushë.

Avokati i Popullit ka realizuar "Ditë të hapura" në shkolla për të promovuar të drejtat e fëmijëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e institucioneve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, veçanërisht për ata në konflikt me ligjin. Aktivitetet kanë përfshirë dhe sensibilizimin e prindërve dhe stafit mësimor, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional.


Bashkitë në të gjithë Shqipërinë, përfshirë Pogradecin, Shkodrën, Gjirokastrën, Lezhën dhe Lushnjën, kanë zhvilluar aktivitete të shumta edukative dhe ndërgjegjëse për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe përfshirjen e fëmijëve në veprime kriminale. Këto aktivitete janë përqendruar në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet dhe viktimizimi, duke ofruar mbështetje sociale dhe psikologjike për ata që janë në rrezik.

Po ashtu, UNICEF ka mbështetur aktivitete për përmirësimin e aftësive të prindërve dhe disiplinimin pozitiv, veçanërisht në Lezhë dhe Shkodër, duke ofruar mbështetje për të siguruar një qasje më miqësore ndaj fëmijëve në sistemin arsimor dhe në familje.

Në përmbljedhje, këto iniciativa janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, për të siguruar siguri në internet dhe për të parandaluar përfshirjen e tyre në aktivitete kriminale, duke përfshirë angazhimin e bashkive, institucioneve dhe shoqërisë civile për mbështetje

dhe edukim të qëndrueshëm.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Dytë Politik “Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:



Në kuadër të mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve janë angazhuar institucione, organizata dhe profesionistë të ndryshëm në krijimin e një sistemi drejtësie që i respekton dhe mbron të drejtat e fëmijëve në çdo fazë.

Avokati i Popullit, me mbështetje financiare nga UNICEF, ka hartuar një raport të rëndësishëm për analizimin e efikasitetit të drejtësisë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare. Ky raport përmban 18 rekomandime, disa prej të cilave synojnë garantimin e një drejtësie më të miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët. Ky dokument është tashmë i dërguar Kuvendit të Shqipërisë, dhe shërben si një udhërrëfyes për të përmirësuar sistemin e drejtësisë për të miturit.

Në kuadër të veprimeve të tjera, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka raportuar për një numër të konsiderueshëm çështjesh me objekt "pension ushqimor", ndërkohë që Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime të vazhdueshme për të garantuar të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë inspektime dhe rekomandime për institucionet e privimit të lirisë dhe komisariteve të policisë.


Një tjetër aspekt i rëndësishëm është angazhimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka propozuar riformulimin e disa dispozitave ligjore për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e vullnetarizmit. Po ashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar udhëzime që synojnë ndjekjen penale efektive të veprave që kanë të bëjnë me të miturit.

Duke vazhduar me këto përpjekje, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë hapa për të parandaluar abuzimet mediatike ndaj të miturve, duke njoftuar dhe sensibilizuar mediat për përgjegjësitë e tyre në raport me këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë. Gjithashtu, janë miratuar rregullore të reja që synojnë mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet mediatike të papërshtatshme.

Në këtë kuadër, Shkolla e Magjistraturës dhe institucione të tjera kanë vazhduar me trajnime të specializuara për profesionistët e drejtësisë, ndërkohë që UNICEF ka ofruar seminare dhe trajnime për të siguruar që të drejtat e fëmijëve të jenë të mbrojtura në çdo fazë të sistemit të drejtësisë.

Për më tepër, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme edukative dhe sensibilizuese në shkolla dhe në bashkitë përkatëse, për të fuqizuar njohuritë juridike të fëmijëve dhe për t'i mbajtur larg aktiviteteve kriminale, gjithashtu duke i informuar ata mbi sistemin e drejtësisë dhe rolin e institucioneve përgjegjëse.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Tretë Politik *“Garantimin e qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:*




Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka bërë hapa të mëdha në sigurimin e informacionit dhe shërbimeve juridike për të miturit dhe kategoritë vulnerabël në vend. Duke përdorur platformat online, si faqen zyrtare dhe rrjetet sociale, ajo ka publikuar informacione të thjeshta dhe të kuptueshme për fëmijët dhe individët që përfitojnë nga ky ligj. Kjo iniciativë ka përfshirë edhe fëmijët në shkolla, duke zhvilluar takime të dedikuara për informimin e tyre mbi shërbimet që ofron linja 08001010 dhe platforma "Juristi online". Gjithashtu, aktivitetet janë zhvilluar në 61 bashki, ku janë shpërndarë materiale informuese dhe postera për të sensibilizuar publikun mbi të drejtat e fëmijëve dhe ndihmën juridike falas.

Një hap i rëndësishëm ka qenë zhvillimi i trajnimeve për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, ku është përfshirë një fokus i veçantë në trajtimin e fëmijëve si përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike, për të siguruar që të drejtat e tyre të mbrohen në mënyrë të duhur.

Për më tepër, Prokuroria e Përgjithshme ka krijuar një rubrikë të dedikuar për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe ka përmirësuar ambientet e prokurorive për t'i ofruar atyre një mjedis miqësor dhe të përshtatshëm për trajtimin e çështjeve të tyre. Po ashtu, në bashkëpunim me UNICEF dhe organizata të tjera, janë zhvilluar praktika dhe trajnime për policinë dhe përmirësuar njësitë e intervistimit për të miturit.

Nga ana tjetër, është punuar intensivisht për të krijuar kushte më të mira për fëmijët që janë në konflikt me ligjin, duke përfshirë zhvillimin e trajnimeve për përmbartuesit gjyqësor dhe rritjen e mbështetjes psikologjike për ta.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Katërt Politik “Drejtësia penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin” konstatohet në:



Përpjekjet dhe rezultatet e arritura në kuadër të reformave për drejtësinë për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar një projektudhëzim që synon promovimin e drejtësisë restauruese, duke u fokusuar tek nevojat e të miturve dhe rrethanat e veprës penale. Nga raportimi për periudhën janar-dhjetor 2024, rezulton se masa e këshillimit është përdorur për 74 të mitur, si një formë shmangie nga dënimet më të rënda.

Po ashtu, janë arritur disa arritje të tjera të rëndësishme, si finalizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Agjencisë Kombëtare të Parandalimit të Abuzimit, e cila ka për qëllim forcimin e formimit profesional të të burgosurve, përfshirë të miturit.


Në këtë kuadër, UNICEF ka realizuar një program për 32 djem të Institutit për të Mitur në Kavajë, duke i ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive dhe prezantimin e projekteve që tashmë janë në proces implementimi. Gjithashtu, janë miratuar udhëzime të përbashkëta për arsimin dhe formimin profesional të të burgosurve, duke përfshirë atyre që janë të rinj në konflikt me ligjin.

Përmes trajnimeve dhe sesioneve informuese, institucione të ndryshme kanë marrë njohuri të thelluara për identifikimin dhe parandalimin e dhunës dhe kriminalitetit tek të rinjtë, si dhe për përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional. Gjatë vitit të kaluar, gjithashtu, janë bërë hapa të rëndësishëm në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe informimin e fëmijëve për përfitimet e programeve rehabilituese dhe ri-integruese.

Në përfundim, këto iniciativa janë dëshmi e angazhimit të përbashkët për të ndihmuar të miturit dhe të rinjtë të kalojnë nga një fazë e vështirë e jetës në një të ardhme më të ndritshme dhe të barabartë. Angazhimi i institucioneve, organizatave ndërkombëtare dhe komunitetit është kyç për arritjen e këtyre objektivave.


II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik I




■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik II




■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik III



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik IV



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara



III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësoj udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim. Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit. Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifika ve për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, me mbështetjen e institucioneve bashkëpërgjegjëse në raportim është mbledhur informacion mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve në Planin e Veprimit si dhe indikatorëve në Pasaportën e Treguesve.

Ky raportim përfshin masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre në vitin 2024 si dhe masat të cilat raportohen rregullisht në mënyrë vjetore.

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNDM-së për vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në faqen zyrtare të MD-së.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)



➤ **Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNDM 2022-2026) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2024, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

➤ **Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNDM (2022-2026) raporte të cilat publikohen në linkun: www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-2/

➤ **Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Kërkesa për kontribut në rrugë elektronike u dërgua në datë 16 dhjetor 2024 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- Kërkesa shtesë për kontribut nga institucionet kontribuese në datën 14 janar 2025. Kjo për arsye se disa institucione nuk kishin dërguar inpute brenda afatit të përcaktuar;
- Kërkesa e dytë për kontribut nga institucionet kontribuese në datën 16 janar 2024. Kjo për arsye se disa institucione ende nuk kishin dërguar inpute brenda afatit të përcaktuar;
- Hartimi i draftit të parë të raportit të performancës në datën 9 prill 2025;
- Dërgimi për konsultim publik në datën 10 prill 2025

- Mbledhja e komenteve/sugjerimeve/dakordësisë, mbi masat/aktivitetet nga konsultimi publik dhe reflektimi i tyre në Raportin e Monitorimit vjetor (25 prill);
- Zhvillimi i takimit të Ekipit Tematik në kuadër të prezantimit dhe miratimit të draft Raportit të Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2024
- Publikimi i Raportit vjetor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- Dërgimi i procedurave të mbledhjes (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC datën.

➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivët Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucio net përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qenë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse. Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin e masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara).

Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

➤ **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:

- ✓ **E zbatuar**: masa e cila është përmbushur plotësisht;
- ✓ **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri;
- ✓ **E pazbatuar**: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së zbatimit të

masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në periudhë janar-qershor 2024.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.

➤ **Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës**

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhë nies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikbërjes. Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 10 prill 2025 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu www.drejtesia.gov.al/konsultime/. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë reflektoi komentet/sugjerimet relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit. Pas miratimit të raportit, Ministria e Drejtësisë publikoi në faqen e saj zyrtare raportin në gjuhën Shqipe.



I. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE

QËLLIMI I PARË I POLITIKËS

“Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve”.

Qëllimi i Parë i Politikës: 12 masa

12 masa të zbatueshme për 2024



Gjatë vitit 2024, janë bërë hapa të mëtijshëm drejt arritjes së Qëllimit të Parë të Politikës. Nga 12 masat e zbatueshme për vitin 2024, 10 masa u zbatuan plotësisht, 1 masë u zbatua pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar. **67%** e masave janë realizuar plotësisht për periudhën raportuese.


Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 1.1 dhe 2 (dy) masa për O.S 1.2. Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 1.1.

“Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë”.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon 10 masa, prej të cilave 8 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është e pazbatuar. **80%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 1.1: 10 MASA



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

✚ Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë nismën për edukim ligjor dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në shkolla.

Fëmijët në shkollë kanë marrë informacione dhe sugjerime nga mësuesit e lëndëve nga fusha “Shoqëria dhe mjedisi” për të drejtat e fëmijës, parandalimin e veprave penale ndaj tyre si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

Në disa institucione arsimore, janë realizuar monitorime të përgjithshme për vlerësimin e zbatimit të programeve mësimore të përmirësuara, duke u fokusuar në respektimin e të drejtave të fëmijëve. Po ashtu, janë realizuar anketa me fëmijë dhe prindër për të matur kënaqshmërinë nga programet mësimore dhe për të vlerësuar klimën shkollore, në bashkëpunim me stafin dhe shërbimin psiko-social.

Takimet informuese janë zhvilluar me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve mbi parandalimin e veprave penale, luftën kundër drogës dhe substancave të rrezikshme, duke përfshirë bashkëpunimin me mësuesit, specialistët e policisë dhe punonjësit e Shërbimit psiko-social. Oficerët e Sigurisë nëpër shkolla kanë realizuar aktivitete informuese për nxënësit, me qëllim parandalimin e veprave penale dhe rreziqeve të viktimizimit, si dhe përfshirjen e fëmijëve në aktivitete kriminale.

✚ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka realizuar një studim të programit lëndor për Qytetarinë për klasat 1-10, i cili përfshin përfshirjen e dimensionit të edukatës ligjore dhe të drejtat e fëmijëve në kurrikulën e kësaj lënde. Ky studim përfshin njohjen e instrumenteve ligjorë që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe mekanizmat që rregullojnë drejtësinë për të mitur dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

✚ Avokati i Popullit ka realizuar gjithsej 46 “Ditë të hapura”, prej të cilave 28 janë organizuar në institucionet e arsimit parauniversitar. Këto aktivitete kishin për qëllim promovimin e rolit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, duke u fokusuar në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përfshirë të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin. Gjithashtu, ato kontribuan në konsolidimin e njohurive të nxënësve, prindërve dhe stafit pedagogjik për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

✚ Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zbatuar projektin "Parandalimi i dhunës dhe i krimit

tek të rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh" në Bashkitë Kuçovë, Lezhë dhe Sarandë.

✚ Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me AKSK gjatë vitit 2024 në kuadër të zbatimit të një marrëveshjeje ndër-institucionale për sigurinë në internet të fëmijëve ka zhvilluar 33 aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese, përfshirë Workshop-e dhe konferenca, që kanë pasur për qëllim të informojnë dhe ndërgjegjësojnë fëmijët dhe profesionistë lidhur me sigurinë në internet. Aktivitetet janë mbajtur në 19 shkolla në Tiranë dhe në 11 bashki të tjera të Shqipërisë. Gjatë këtyre takimeve, janë ndërgjegjësuar 1,277 fëmijë dhe 244 profesionistë mbi mënyrat e raportimit të rasteve të bullizmit, ngacmimeve dhe shantazheve online, si dhe janë ndarë praktikat më të mira për një lundrim të sigurt në internet.

✚ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka realizuar 39 aktivitete ndërgjegjësuëse për rritjen e njohurive mbi bullizmin dhe sigurinë në internet. Po ashtu, janë mbajtur 10 trajnime, nga të cilat 5 për oficerët e sigurisë në shkolla dhe 5 për mësuesit, duke kontribuar në forcimin e sigurisë në internet.

✚ Këshilli i Ankesave i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka shqyrtuar 55 ankesa të lidhura me të miturit në mjedisin mediatik, që përbëjnë 15.9% të të gjitha ankesave të depozituara. AMA dhe Këshilli i Ankesave monitorojnë me vëmendje përmbajtjet audiovizive që transmetohen, duke u siguruar që ato të respektojnë ligjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së fëmijëve, veçanërisht gjatë transmetimeve të tilla.

✚ Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 20 nëntor, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me ASHDMF zhvilloi një takim me pjesëmarrës rreth 30 fëmijë, nga qytete të ndryshme të vendit (Shkodër, Elbasan, Tiranë, Kamëz, Burrel). Në këtë takim u diskutua mbi të drejtat e fëmijëve, me fokus Planin e Veprimit, në zbatim të rekomandimeve të Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve. 2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvilloi takime në 4 bashki të vendit (Durrës, Shkodër, Berat dhe Elbasan) në kuadër të Platformës së Komunikimit për Gjithëpërfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, ku prezantoi gjetjet e Raportit afatmesëm të monitorimit 2021-2023 dhe "Fjalorthin për gjuhën gjithëpërfshirëse ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara". Ky fjalorth përmban konceptet dhe terminologjinë më një gjuhë gjithëpërfshirëse, miqësore dhe mosdiskriminuese në përputhje me standartet ndërkombëtare për aftësinë e kufizuar.

✚ Shërbimi Social Shtetëror ka krijuar një manual për sesionet e edukimit dhe informimit për fëmijët në institucionet rezidenciale të kujdesit, duke përdorur një gjuhë miqësore. Nga janari në qershor, janë zhvilluar 4 sesione edukimi në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe parandalimin e veprave penale në Shtëpinë e Fëmijës në Tiranë dhe në Sarandë, ku janë trajnuar 50 fëmijë dhe 23 punonjës të institucioneve.

✚ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në saj të bashkëpunimit me prezencën e OSBE ka bërë të mundur për herë të parë në Shqipëri hartimin dhe printimin e manualit të thjeshtëzuar: "Ke nevojë për ndihmë juridike" në gjuhën Brail. Ky manual i është vendosur në dispozicion tek të gjitha shoqatat e të verbërve që operojnë në Shqipëri. Gjithashtu, ka përditësuar informacionin online në mënyrë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme për fëmijët duke përfshirë dhe videoje të thjeshtëzuar mbi "Ndihmën Juridike Falas".

✚ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për informimi e viktimave të krimit për të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve duke zhvilluar 17 dalje në media në adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe promovimit e barazisë, si dhe kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare. Përmes Zyrrave Rajonale në Shkodër, Korçë dhe Fier. KMD ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë trajtuar edhe temën e diskriminimit të miturve në konflikt me ligjin dhe jo vetëm. Gjithashtu, ka kryer takime dhe aktivitete të cilat fokusohen kryesisht në çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe parandalimin e dhunës dhe trafikimit.

✚ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërmoi iniciativën për të zhvilluar një *Modul Trajnues* mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në internet”, i cili po përdoret nga mësuesit dhe nxënësit për të përmirësuar përdorimin e rrjeteve sociale dhe sigurinë online. Për prezantimin e gjetjeve të Rekomandimit Unifikues dhe të Modullit Trajnues, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), zhvilluan aktivitetin përmbyllës të kësaj iniciative. Me një pjesëmarrje të gjerë të drejtuesve, mësuesve, psikologëve, prindërve dhe nxënësve. Në këtë takim u theksua rëndësia e ndërveprimit mes të gjithë aktorëve dhe faktorëve në funksion të misionit të përbashkët dhe edukimit sa më cilësor të brezit të ri.


✚ Bashkia Lushnjë ka bashkëpunuar me Zyrën e Shërbimit të Provës për të trajtuar 25 raste të mitur me konflikt me ligjin gjatë vitit 2024, duke ofruar mbështetje psikologjike dhe mundësi ri-integrimit në shoqëri për t'i mbajtur ata larg kriminalitetit. Gjithashtu, është punuar në parandalimin e viktimizimit të tyre. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social dhe punonjësit e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, janë realizuar aktivitete dhe takime informuese dhe sensibilizuese në shkollë dhe në Qendrën Multifunkionale “Rinore”. Këto aktivitete kishin për qëllim rritjen e sigurisë së fëmijëve në shoqëri, parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në vepra penale dhe viktimizimin e tyre. Temat e trajtuara përfshinin të rinjtë në konflikt me ligjin, krimin, abuzimet online. Njësia për mbrojtjen e fëmijëve ka kryer gjithashtu takime dhe vizita në familje për të identifikuar, monitoruar dhe më pas trajtuar problematikat socio-ekonomike të tyre. Një pikë tjetër kyçe kanë qenë takimet informuese me prindër të fëmijëve, për të informuar dhe ardhur në ndihmë me informacione mbi temat si: interneti i sigurt, pasojat ligjore dhe psikologjike.

✚ Bashkia Pogradec ka menaxhuar 33 raste të fëmijëve në rrezik për braktisje të shkollës dhe ka organizuar 32 aktivitete informuese mbi tematika të ndryshme si parandalimi i akteve të dhunshme etj.

✚ Bashkia Gjirokastrë ka organizuar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke përfshirë institucione të ndryshme si prokuroria, policia dhe arsimit. Në bashkëpunim me shërbimin ligjor Tlas dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas Gjirokastrë janë organizuar takime informuese ndërgjegjësuere ku janë diskutuar dhe raste për ndërhyrje.

✚ Bashkia Shkodër ka ofruar shërbime për fëmijët dhe familjet e tyre nëpërmjet Qendrave Komunitare për Familjen, ku janë zhvilluar aktivitete edukative si kampet verore dhe shërbime gjatë gjithë vitit.

✚ Bashkia Berat ka zhvilluar 17 takime periodike në komunitet, në Qendrën Komunitare me SPZ



e qytetit dhe NJA, psikologët shkollorë, punonjësit e shërbimit të provës me prindërit e fëmijëve në rrezik braktisje të arsimit të detyruar në lidhje me parandalimin dhe përfshirjen në vepra penale ose nga ri- viktimizimi prej tyre.

✚ Bashkia Durrës ka kryer takime me teme informimi, ndërgjegjësimi në mënyrë periodike (çdo 3 muaj) me shkollat që kanë probleme me nxënësit në rrezik braktisje të shkollës kryesisht në zonat rurale.

✚ Bashkia Lezhë ka realizuar 25 takime në shkolla të ndryshme dhe kanë marrë informacion rreth 450 fëmijë. Janë zhvilluar takime periodike në komunitet ku janë përfshirë prindër të fëmijëve të grupmoshave të ndryshme, të cilët janë informuar rreth parandalimit të përfshirjes së fëmijëve në vepra penale (15 takime/30 prindër). Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime në banesë me familjarët e fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe janë identifikuar nevojat e familjes në kushtet sociale ekonomike.

✚ Bashkia Vlorë ka trajtuar përmes NJMF, 25 raste të të miturve në konflikt me ligjin në bashkëpunim me policinë dhe prokurorinë. Gjatë sesioneve informuese të realizuara në shkollat e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, me pjesëmarrjen e stafit pedagogjik dhe nxënësve, është përcjellë informacion mbi konceptin e barrës që rëndon mbi veprat penale të kryera nga të miturit, bazuar në informacionin KDPM për të mitur në konflikt me ligjin. Në kuadër të zbatimit të programeve informuese dhe ndërgjegjësuere me fokus fëmijët janë realizuar takime të herëpashershme sipas problematikave të paraqitura dhe rasteve të referuara nga institucionet arsimore, takime në komunitet me NJMF, policët specialistë të zonave, specialistë të shërbimit mbështetës për fëmijët dhe familjet si dhe njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile për të informuar fëmijët dhe prindërit në lidhje me ndjekjen e arsimit të detyruar si dhe takime pranë familjeve me prindër të fëmijëve me probleme të ndryshme sociale.

✚ Bashkia Dibër, është pjesë e një programi e cila mbështetet nga fondi i Ministrisë së Arsimit dhe targeton fëmijët në rrezik braktisje për tu mbështetur, për të parandaluar braktisjen e arsimit dhe për të parandaluar përfshirjen e tyre në vepra penale në të cilën janë përfshirë rreth 150 fëmijë.

✚ Bashkia Pukë, ka kryer fushata ndërgjegjësuere në lidhje me trafikimin e fëmijëve të mitur, fushata ndërgjegjësuere për mosbraktisje të mësimi, aktivitete dhe lojëra zbavitëse, kampe verore në bashkëpunim me OJF.

✚ Bashkia Kamëz, ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete që kanë në qendër rehabilitimin dhe risocializimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.

✚ Bashkia Tiranë, ka fokusuar përpjekjet për identifikimin dhe ndihmën e fëmijëve që janë jashtë sistemit shkollor dhe potencialisht të braktisin shkollën. Për vitin 2024 janë identifikuar 22 fëmijë jashtë sistemit shkollor, dhe janë bërë përpjekje për t'i rikthyer ata në shkolla.

✚ Bashkia Korçë, ka organizuar fushata ndërgjegjësuere në zona të ndryshme si, në zonën këmbësore të qytetit, njësive administrative, shkolla, familje të veçanta të cilat kanë fëmijë në rrisht braktisjeje.


✚ UNICEF ka mbështetur institucione në Lezhë dhe Shkodër për të zbatuar një qasje miqësore ndaj fëmijëve, duke përfshirë aktivitete me prindërit për të përmirësuar aftësitë e tyre të prindërimit dhe disiplinimin pozitiv.

➤ Objektivi Specifik 1.2.

Fuqizimi i mekanizmave të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku janë përfshirë fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.2 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave janë zbatuar pjesërisht. **100%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 1.2: 2 masa



Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës I:



- Adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve te organet përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e programeve parauniversitare.
- Programe për parandalimin e formave të ndryshme të bullizmit në rrjetet sociale të zhvilluara në shkolla, në institucionet e kujdesit shoqëror dhe për fëmijët në risk.
- Emisione në mediat audiovizive (Radio Televisioni Shqiptar) me një gjuhë miqësore mbi kuptimin, zbatimin dhe promovimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve.
- Identifikimi dhe promovimi i rasteve të suksesit të nismave rinore dhe fëmijëve të integruar në shoqëri.

QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS

“Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Dytë i Politikës: 23 masa

23 masa të zbatueshme për 2024



Plani i Veprimit për Qëllimin e Dytë të Politikës parashikon 23 masa, prej të cilave 13 masa janë zbatuar plotësisht dhe 6 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 4 masa të pazbatuara 57% e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 2.1, 11 (njëmbëdhjetë) masa për O.S 2.2 dhe 2 (dy) masa për O.S 2.3.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara).

➤ Objektivi Specifik 2.1

Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon parashikon 10 masa, prej të cilave 3 masa janë zbatuar plotësisht dhe 7 masa rezultojnë të zbatuara pjesërisht. 50% e masave janë zbatuar plotësisht

Objektivi Specifik 2.1: 10 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Avokati i Popullit ka hartuar raportin e veçantë “Analizë e efikasitetit të drejtësisë për fëmijët, në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare” me mbështetjen financiare të UNICEF-it, raport në të cilin janë dhënë 18 rekomandime ku përfshihen dhe rekomandime që lidhen drejtpërdrejt me garantimin e një drejtësie miqësore për fëmijët (raport dërguar Kuvendit të Shqipërisë).
- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit për vitin 2024 raporton se 8,619 janë çështje me objekt “pension ushqimor”, nga të cilat 72 janë ekzekutuar dhe 8,489 janë në ekzekutim të vazhdueshëm, 38 të transferuara, 3 pezulluar me vendim gjykatë, 10 pushuar.
- ✚ Avokati i Popullit ka adresuar 34 rekomandime me objekt mbrojtjen dhe garantimin e të gjithë të drejtave të fëmijëve (SF). Avokati i Popullit nëpërmjet MKPT-së ka vijuar me inspektimet në komisaritet e policisë/institucionet e privimit të lirisë dhe ka hartuar 42 rekomandime me objekt edhe të drejtat e të miturve në kontakt me drejtësinë. Gjithashtu, ka inspektuar Institutin e të Miturve në Kavajë dhe ka drejtuar rekomandimin me gjetjet përkatëse.
- ✚ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në dhjetor të vitit 2024, ka propozuar rekomandime në lidhje me Projekt-ligjin “Për vullnetarizmin”, ku ndër të tjera ka propozuar që të bëhen riformulime të dispozitave duke parashikuar që vullnetari i huaj, në moshë të mitur, të gëzojë në mënyrë të barabartë, të gjitha të drejtat e parashikuara për vullnetarët e mitur, shtetas shqiptarë.
- ✚ Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17/2021 "Për ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshimtarë i veprës penale". Ky akt udhëzon prokurorët e seksionit për të mitur dhe prokurorët e ngarkuar për të ndjekur çështjet me të mitur në prokuroritë ku nuk janë ngritur seksione, të bashkëpunojnë me njëri tjetrin për shkëmbimin e eksperiencave të hetimit, ndjekjes penale dhe zbatimit të politikës penale ndaj të miturve, si dhe zhvillimin e praktikave më të mira, me qëllim përmirësimin e zbatimit të kuadrit normativ të drejtësisë penale për të mitur. Për këtë qëllim, prokurorët nxiten të krijojnë e të marrin pjesë vullnetarisht në Rrjetin e Prokurorëve të Drejtësisë Penale për të Mitur, si një mekanizëm bashkëpunimi që funksionon në përputhje rregullat e përcaktuara nga vetë ata.
- ✚ Autoriteti i Mediave Audiovizive ka bërë 3 reagime të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare ndaj OSHMA-ve duke tërhequr vëmendjen e subjekteve audiovizive, në rastet e abuzimit me të dhënat e të miturve apo presionin e disa mediave, për përfshirjen e të miturve në kronika të ndryshme. Autoriteti i Mediave Audiovizive, përmes thirrjeve sensibilizuese në faqen zyrtare të ëeb-it, në mënyrë të vazhdueshme synon të nxisë dhe të ndërgjegjësojë të gjitha mediat që të angazhohen në evitimin e përmbajtjeve të papërshtatshme, me qëllim pasqyrimin profesional dhe etik të ngjarjeve, në respekt të dinjitetit të interesit më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, u miratua rregullorja “Për kërkesat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përmbushin për krijimin e ofrimit të sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim” që ka në fokus gjithashtu edhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në rubrikën e dedikuar “Edukimi Mediatic” në faqen zyrtare të AMA-s, si edhe në llogaritë e Autoritetit në rrjetet sociale publikohen vazhdimisht informacione, video dhe materiale të tjera ndërgjegjësuëse që kanë për qëllim, ndër të tjera, edhe


mbrojtjen e fëmijëve ndaj ekspozimit mediatic.

➤ Objektivi Specifik 2.2

Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon parashikon 11 masa, prej të cilave rezulton se 7 masa janë të zbatuara plotësisht dhe 2masa janë të zbatuara pjesërisht dhe 2 masa të pazbatuara. **64%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.2: 11 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2024, Shkolla e Magjistraturës ka organizuar 5 sesione trajnuese me fokus trajnimin e profesionistëve në fushën e drejtësisë për të miturit.
- ✚ Në fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, zhvillohen tema mësimore për drejtësinë penale për të miturit, duke përfshirë disa lëndë kryesore si: "Barazia dhe Ligji"; "Të drejtat e Njeriut"; Teknikat dhe "Taktikat e pyetjes" etj. Gjithashtu, në nivelin Master për " Sigurinë dhe Hetimin" është vendosur lënda "Drejtësia Penale për të Miturit". Kurrikula për çështjet e drejtësisë penale për të mitur, është gjithëpërfshirëse në temat që trajton, në mënyrë që të jetë në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare.
- ✚ Çdo institucion përgjegjës ka krijuar regjistra me të dhëna të profesionistëve të trajnuar/specializuar në fushën e drejtësisë miqësore për fëmijë.
- ✚ UNICEF përmes stafit të vet ka ofruar seminare dyditore mbi kuptimin e drejtë dhe zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe për Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga ana e Policisë së Shtetit me pjesëmarrjen e punonjësve të policisë, përfaqësues të policisë gjyqësore, të prokurorive, të zyrave të shërbimit të provës, të zyrave të ndihmës ligjore falas, stafi i qendrave me një ndalesë për viktimat e dhunës seksuale në Fier dhe Shkodër, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës

apo të drejtorive të shërbimeve sociale të bashkive përkatëse por edhe OJF të cilat angazhohen me shërbime për fëmijët në konflikt a kontakt me ligjin.


- Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme në kuadër të drejtësisë miqësore për fëmijë në lidhje me teknikat miqësore të intervistimit të të miturve, viktimave të dhunës fizike dhe abuzimit seksual si dhe ofrimit të asistencës ndaj të miturit viktimë/dëshmitar të veprës penale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin prokurorë, oficerë, koordinatorë, nga të gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
- Gjatë vitit 2024, ASHDMF, në bashkëpunim me QPKMR, organizoi takime trajnuese dhe sesione informuese për identifikimin e hershëm të dhunës dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në parandalimin e dhunës dhe kriminalitetit të rinjtë. Përveç kësaj, u zhvilluan takime informuese dhe ndërgjegjësuere me nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në bashkitë përkatëse. Gjatë këtyre takimeve, 145 fëmijë u angazhuan në diskutime për fuqizimin e njohurive juridike dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, me qëllim mbajtjen e tyre larg aktiviteteve kriminale. Fëmijët u informuan gjithashtu mbi sistemin e drejtësisë, drejtësinë penale për të mitur dhe funksionimin e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Takimet me fëmijët kishin si fokus edukimin ligjor në shkolla dhe theksimin e rolit të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të miturve.
- Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, gjatë kësaj periudhe ka publikuar në faqen zyrtare dokumentin “Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve” i cili synon të ofrojë orientime dhe standarde për trajtimin e fëmijëve në sistemin e drejtësisë, duke siguruar që ata të trajtohen me respekt dhe të drejtat e tyre të jenë të mbrojtura në çdo fazë të procesit gjyqësor duke inkurajuar krijimin e një mjedisi që lejon fëmijët të kuptojnë dhe të marrin pjesë në proceset gjyqësore në mënyrë që të ndihmohet në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe të sigurohet drejtësia për ta.

➤ Objektivi specifik 2.3

Forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare të miratuara në fushë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon parashikon 2 masa prej të cilave rezulton se 1 masë është e zbatuar plotësisht dhe 1 masë është e zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.3: 2 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

✚ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, gjatë vitit 2024, ka siguruar mbështetje për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale që përfshijnë fëmijët ose ku vendimmarrja ndikon drejtpërdrejt tek të miturit. Në periudhën Janar-Dhjetor 2024, janë ofruar shërbime juridike për gjithsej 279 të mitur, përfshirë: 202 çështje administrative, 26 çështje penale, 31 çështje civile dhe 20 çështje për të cilat nuk është e përcaktuar kategoria përkatëse.

✚ Me mbështetje nga UNICEF, gjatë këtij viti janë trajnuar gjithsej 83 profesionistë (23 burra dhe 60 gra) nga institucione të ndryshme, përfshirë prokuroritë, gjykatat, zyrat e shërbimit të provës, Institutin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Kavajë, Qendrën për Parandalimin e Krimeve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe përfaqësues të forcave të policisë, për përdorimin e sistemit të ri në të gjithë vendin. Po ashtu, 40 profesionistë (7 burra dhe 33 gra) janë mentoruar për procesin e regjistrimit të të dhënave përmes 31 sesioneve mentorimi. Formularët për regjistrimin e të dhënave janë unifikuar për të gjitha institucionet që përdorin këtë sistem.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës II:



- ✚ Evidentimi dhe promovimi i praktikave më të mira të çështjeve gjyqësore për të miturit.
- ✚ Hartimi i një udhëzuesi i cili përcakton qartësisht definicionin e interesit më të lartë të fëmijëve.
- ✚ Hartimi i një modeli të unifikuar të të dhënave të profesionistëve të trajnuar/specializuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse nga MD.

QËLLIMI I TRETË I POLITIK

“Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë. Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Tretë i Politikës: 10 masa

10 masa të zbatueshme për vitin 2024



Plani i Veprimit për Qëllimin e Tretë të Politikës parashikon 10 masa, prej të cilave 5 masa janë zbatuar plotësisht dhe 5 masa janë zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 2 (dy) masa për O.S 3.1, 5 (pesë) masa për O.S 3.2 dhe 3 (tre) masa për O.S 3.3.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 3.1

Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionist të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave 1 masë zbatuar plotësisht dhe një masë pjesërisht . **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.1: 2 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara

■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

📌 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në faqen e saj zyrtare si dhe në rrjetet sociale ka publikuar një informacion ligjor mbi përfitimin e ndihmës juridike, në një formë të thjeshtë dhe të kuptueshme nga të miturit si dhe nga personat e tjerë kategori përfituese e ligjit. Gjithashtu, për informimin e fëmijëve nëpër shkolla në lidhje me ekzistencën dhe shërbimin që ofron linja 08001010 (Linja e gjelbër)/ platforma “Juristi online”, por dhe informimi mbi njohjen e kategorive përfituese që ligji për ndihmën juridike i kategorizon fëmijët/të miturit si përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve ligjore, zhvillohen takime në ambientet e shkollave nga punonjësit me trajnim të posacëm të 20 Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Konkretisht, përgjatë vitit 2024, nga 20 QSHNJP janë zhvilluar aktivitete në 61 Bashki ku është mundur ofrimi i informacionit mbi shërbimet që përfitojnë kategoritë vulnerabel, përfshirë këtu edhe të miturit, si dhe është mundur afshimi i posterave në ambientet kryesore të bashkive. Më tepër informacion mbi aktivitetet gjendet i publikuar në buletinet mujore informative të DNJF.

Nga viti 2024, janë zhvilluar trajnime dhe praktika 2-mujore të studentëve të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët janë informuar mbi ofruesit e ndihmës juridike falas, kushtet për

përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas. Një fokus të vecantë gjatë trajnimeve/praktikave me studentët është theksuar dhe tek të miturit, duke treguar kujdes të shtuar në mënyrën e pritjes dhe evidentimit të problematikave të tyre, për tu bërë e mundur realizimi i të drejtave të tyre, si përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.


- ✚ Në faqen zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm është krijuar një rubrikë e dedikuar me informacione ndërgjegjëse në ndihmë të të miturit në konflikt me ligjin. Letra e të drejtave i “Mitur në konflikt me ligjin”.

➤ Objektivi Specifik 3.2

Shërbime të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë të ofruara në mjedise të aksesueshme për ta.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon 5 masa, prej të cilave 3 masa është zbatuar plotësisht dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht. **60%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.2: 5 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me UNICEF, përgatiti Manualin për "Teknikat Shkencore të Intervistimit me të mitur" dhe ka shpërndarë në rrugë elektronike tek punonjësit e Policisë së Shtetit që ishin pjesë e trajnimeve të kryera, nga gjitha drejtoritë vendore të policisë në vend. Gjithashtu, Drejtoria është duke bashkëpunuar me OJF "OUR" dhe "CIVI Pol" për rikonstruksione të njësive të intervistimit nëpër qarqe, si dhe financimin për ngritjen e njësive të reja të intervistimit nëpër komisaritet e policisë. Organizata “Nisma për Ndryshim Shoqëror -ARSIS” në bashkëpunim me Policinë e Shtetit ka kryer studimin me temë “Fëmijët në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprave penale në Shqipëri - Profili dhe përvoja në reagimin e menjëhershëm në Komisaritet e Policisë dhe Sistemin e Mbrojtjes” dhe ka prezantuar gjetjet e tij institucionet përkatëse ku trajtojnë çështjet të drejtësisë

penal me të mitur, si DPPSH, Akademia e Sigurisë, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve, përfaqësues të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Tiranë, Urdhrit i Punonjësit Social, Unicef dhe përfaqësues të OJF të ndryshme.


- ✚ Prokuroria e Përgjithshme ka krijuar ambiente miqësore për të mitur në prokurori që pas hyrjes në fuqi të KDPM, por ka në vëmendje përmirësimin e tyre si në kuadër të hartës së re gjyqësore ashtu edhe në arritjen e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare. Prokurori i Përgjithshëm ka udhëzuar të adresohen në hartimin e projektbuxhetit nga prokuroritë e shkallës së parë, edhe kërkesat lidhur me ambientet për të miturit.
- ✚ Nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit janë përmirësuar shërbimet për fëmijët të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor dhe po punohet për krijimin e mjediseve miqësore për fëmijët në zyrën e përmbartimit gjyqësor Tiranë. Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka miratuar programet e trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbartuesit gjyqësor si dhe është evidentuar nevoja e psikologëve në strukturën e shërbimit dhe është në proces realizimi.

➤ Objektivi Specifik 3.3

Shërbime mbështetëse të standartizuara, të arritshme për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.3 parashikon parashikon 3 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht

Objektivi Specifik 3.3: 3 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Po vijohet me vlerësimin e nevojave për burimet njerëzore të nevojshme dhe rishikimin i organigramës së çdo institucioni që punon me dhe për fëmijët (DHKA, DNJF, DPP UP, UPS, NJMF pranë bashkive).
- ✚ Gjatë periudhës 2024, ka vijuar edhe vlerësimi i kostove të ndihmës psikologjike të garantuar nga shteti për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin nga Prokuroria e Përgjithshme.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme raporton se pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm janë të publikuara edhe listat e ekspertëve psikolog që asistojnë fëmijën në çdo proces ku fëmija merr pjesë.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës III:


- ✚ Përmirësimi i shërbimeve në gjykata dhe prokurori, për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin, për të ofruar mjedise miqësore në godinat e reja, sipas hartës gjyqësore të miratuar.
- ✚ Fonde për sigurimin e ambjenteve të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të SHP dhe institucioneve të saj të varësisë.
- ✚ Fonde për përshtatje të ambjenteve me mjedise miqësore për fëmijë në buxhetin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor shtetëror.

Qëllimi i Katërt i Politikës


Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe ri-integrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Qëllimi i Katërt i Politikës: 19 masa

19 masa të zbatueshme për vitin
2024



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara ■ Të pazbatueshme



Plani i Veprimit për Qëllimin e Katërt të Politikës parashikon 19 masa, prej të cilave 11 masa janë zbatuar plotësisht, 8 masa janë zbatuar pjesërisht. **58%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 4 (katër) masa për O.S 4.1, 3 (tre) masa për O.S 4.2, 7 (shtatë) masa për O.S 4.3, 3 (tre) masa për O.S 4.4 dhe 2 (dy) masa për O.S 4.5.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ **Objektivi Specifik 4.1.**

Zgjerimi i mundësive të mbikqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon parashikon 4 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 3 masa janë zbatuar pjesërisht. **25%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.1: 4 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Me qëllim konsolidimin dhe shpërndarjen e praktikave më të mira, Prokuroria e Përgjithshme është në proces të hartimit të një metodologjie për të mbledhur e analizuar vendime të shmangies nga ndjekja penale që nga fillimi i zbatimit të KDM.
- ✚ Shkolla e Magjistraturës ka realizuar 2 trajnime në kuadër të zbatimit të masave alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale dhe referimi në programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin.

➤ Objektivi Specifik 4.2

Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e krimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.2 parashikon parashikon 3 masa, 2 masa prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht. **67%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 4.2: 3 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Prokuroria e Përgjithshme hartoi një projektudhëzim që, ndër të tjera, parashikon promovimin e përdorimit të masave të drejtësisë restauruese, duke u bazuar në nevojat e të miturit dhe në rrethanat e kryerjes së veprës penale.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme raporton se gjatë periudhës janar- dhjetor 2024, nga të dhënat statistikore të prokurorive rezulton të jetë aplikuar ndaj 74 të miturve këshillimi si masë shmangie.

➤ Objektivi Specifik 4.3

Struktura mbikëqyrëse që garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërizimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 7 masa, 5 prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 2 janë zbatuar pjesërisht. **71%** e masave janë zbatuar plotësisht

Objektivi Specifik 4.3: 7 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DPB dhe AKPA, është finalizuar me qëllim forcimin e formimit profesional në sistemin e burgjeve, përfshirë edhe të burgosurit e mitur. Po ashtu, është miratuar udhëzimi i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MEKI), për arsimin dhe formimin profesional të të burgosurve.
- ✚ Në këtë kuadër, është nënshkruar gjithashtu një marrëveshje bashkëpunimi mes MD dhe MAS për arsimin e të burgosurve. UNICEF ka sjellë programin UPSHIFT për një grup të veçantë fëmijësh, 32 djem të Institutit për të Mitur në Kavajë, gjatë Javës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës. Ky program u zhvillua në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Qendrën e Parandalimit të Kriminalitetit për të Mitur, dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Gjatë një workshopi 3-ditor, të rinjtë krijuan dhe prezantuan katër ide për projekte, nga të cilat njëra mori mbështetje nga UNICEF dhe është duke u realizuar, ndërsa tre të tjerat janë mbështetur nga aktorë të sektorit publik dhe privat dhe janë në fazë zbatimi.
- ✚ Po ashtu, një udhëzim i përbashkët midis MEKI dhe MD për zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional të të burgosurve është nënshkruar nga MD dhe pritet të firmoset nga MEKI.
- ✚ Gjatë periudhës 2024, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me CARITAS Shqipëri është miratuar projekt manuali për detyrat e punonjësit të angazhuar në veprimtari e rekreacionit të fëmijëve në konflikt me ligjin. Gjithashtu, ka hartuar dhe miratuar Protokollin e Mekanizmit për referim për riintegrim në shoqëri të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin, ku përshkruhen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë proces.
- ✚ Gjatë periudhës prill-nëntor 2024, ASHDMF, në bashkëpunim me QPKMR, organizoi trajnime dhe sesione informuese në disa bashki të Shqipërisë (Malësi e Madhe, Dibër, Shkodër, Gjirokastrë, Kamëz, Dimal, Kuçovë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë). Këto trajnime u ndoqën nga 151 përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si NJMF, oficerë sigurie, shërbimi i provës, prokuroria, struktura të policisë, psikologë dhe punonjës socialë. Qëllimi i këtyre takimeve ishte për të identifikuar dhe parandaluar dhunën dhe kriminalitetin tek të rinjtë, si dhe për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Pjesë e trajnimeve ishte informimi dhe trajnimi i NJMF dhe aktorëve vendorë për procedurat e menaxhimit të rasteve të fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale. Po ashtu, u

zhvilluan takime me nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme për t'i fuqizuar ata me njohuri ligjore dhe për t'i informuar mbi sistemin e drejtësisë, drejtësinë penale për të mitur dhe Qendrën për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Takimet me fëmijët kishin si fokus edukimin ligjor dhe rëndësinë e mbrojtjes së të miturve.


- ✚ Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar “Hartën e Shërbimeve Sociale” në bashkëpunim me ekspertë të PNUD dhe është publikuar në faqen zyrtare të SHSSH dhe PNUD. Ky dokument paraqet shpërndarjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas tipologjisë, burimit të financimit, grupeve përfituese dhe institucioneve ofruese, duke përdorur të dhëna administrative nga të 61 bashkitë. Ai vlerëson aksesin në shërbime dhe analizon kapacitetet administrative, institucionale, njerëzore dhe financiare për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit.
- ✚ Në lidhje me informimin e fëmijës për përparësitë dhe përfitimet e programeve rehabilituese/ri-integruese për një përzgjedhje sa më efektive të programit e cila siguron riintegrim të qendrueshëm të fëmijës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raporton se kryhet rregullisht nga IM Kavajë.

➤ Objektivi Specifik 4.4

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka kapacitetet e duhura në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 3 masa, 2 prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht. **67%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.4: 3 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Nga ana e QPKMR është vijuar me punën sa i takon ndjekjes së ecures së rasteve të suksesshme të të miturve të cilët janë trajtuar me programe riintegrimi pas vuajtjes së dënimit. Të miturit që kanë përfunduar dënimin në IM Kavajë kanë ndjekur edhe kurse profesionale.


- Një arritje e rëndësishme në këtë proces është përfundimi dhe miratimi i modulit për hedhjen e të dhënave nga QPKMR, në bashkëpunim me ekspertët e UNICEF, modul i cili i është përcjellë dhe AKSHI-t për ta integruar në Sistemin e Integruar, por që moduli i QPKMR nuk është shtuar ende në sistem. Ky zhvillim do t'i mundësojë stafit të QPKMR-së që të vazhdojë hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar në mënyrë të rregullt dhe të qëndrueshme konform legjislacionit në fuqi. Gjithashtu është trajnuar dhe stafi që do të merret me hedhjen e të dhënave në sistem.
- Në kuadër të mirëfunksionimit dhe zhvillimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, QPKMR përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 ka organizuar disa takime me mbikëqyrësit e Sistemit duke bërë bashkë të gjithë institucionet përdoruese të këtij sistemi përfshirë Shërbimin e Provës, Policinë, Prokurorinë, Gjykatën si dhe ekspertët e kontraktuar nga UNICEF. Ky takim është asistuar dhe nga përfaqësuesi i AKSHI-t për Ministrinë e Drejtësisë, i cili aktualisht ka dhe rolin e administratorit të Sistemit të Integruar.
- Nisur nga bashkëpunimi që ka vendosur Ministria e Drejtësisë me UNICEF për kontraktimin e dy ekspertëve në kuadër të asistencës për ngritjen e kapaciteteve të përdoruesve për Sistemin e Integruar deri në muajin dhjetor 2024, në muajin qershor janë organizuar trajnime online nga ekspertët e UNICEF për përdoruesit e rinj, por dhe atyre ekzistues të Sistemit të Integruar dhe konkretisht me përdorues nga Prokuroritë dhe nga Shërbimi i Provës, si dhe janë trajnuar online edhe të gjithë përfaqësuesit e gjykatave. Konkretisht, janë zhvilluar dy trajnime online me përfaqësuesit e Prokurorive dhe me përfaqësuesit e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës nga ekspertët e UNICEF, në lidhje me rolin e tyre si përdorues të sistemit, pra hedhës të dhënash, si dhe është bërë trajnimi edhe për mbikëqyrësin e Shërbimit të Provës. Gjithashtu, ekspertët janë në dispozicion të ofrimit të asistencës së tyre teknike dhe mentorimit në rast se përdoruesit do hasin vështirësi në hedhjen e të dhënave në vazhdimësi.

➤ **Objektivi Specifik 4.5**

Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërinstitutional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijën.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.4 parashikon parashikon 2 masa, 1 prej të cilave është zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.5: 2 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve raporton se në zbatim të planit të aktiviteteve me temë “Së bashku për mbrojtjen dhe integrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin”, në bashkëpunim me ASHDMF-në po zhvillohen takime me të gjithë rrjetin ndërinstitutional në bashkitë kryesore të vendit për të parë funksionimin e plotë të rrjetit ndërsektorial. Për vitin 2024 janë zhvilluar 4 takime në Bashkitë Korçë, Berat, Shkodër dhe Vlorë.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës IV:

- Vlerësimi i shkallës së ripërfshirjes në krim të fëmijëve ndaj të cilëve janë zbatuar më parë masa alternative e shmangies nga ndjekjen penale ose procedimi gjyqësor me qëllim njohjen e faktorëve që kanë ndikuar në rifutjen e të miturit në krim dhe parandalimin e tyre.
- Krijimi dhe azhurnimi i dashboardit (mbledhës të dhënash) për të dhëna të drejtësisë për të mitur, me qëllim analizimin/orientimin e politikave penale dhe sociale për parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve dhe viktimizimin e tyre si dhe për të planifikuar burimet njerëzore dhe financiare.
- Akses i kufizuar i sitemit si shkak i mosfunksionimit të tij, e cila sjell pamundësinë e hartimit të raporteve sipas afateve të përcaktuara në kuadër të mbledhjes të të dhënave nga institucionet përkatëse që trajtojnë raste me të mitur.

II. NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024

Niveli i realizimit në total për 64 masa:





Plan i Veprimit, për periudhën janar-dhjetor, parashikon 64 masa në të cilat institucionet përgjegjëse raportojnë progresin përfshirë masat të cilat raportohen rregullisht dhe masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre gjatë vitit 2024.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2024, **58%** e masave janë zbatuar plotësisht, **31%** e masave janë zbatuar pjesërisht dhe **11%** e masave janë të pazbatuara.

➤ Vlerësimi i sfidave, hapat në vijim

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2024*, rezulton se institucionet kanë treguar performancë të mirë për këtë periudhë raportimi por ende ka aktivitete të parealizuara/pazbatuara/paraportuara.

Në adresimin e performancës nga institucionet, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2023-2024, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- ✚ Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me masën e caktuar për zbatim, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim politikash duhet të ndërlidhet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitutional.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar – dhjetor 2024*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- ✚ Të vijojë zbatimi i masave në statusin “zbatuar pjesërisht/në proces” sipas afateve të parashikuara;
- ✚ Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- ✚ Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- ✚ Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së



nevojshme për kryerjen e tyre;

- + Dërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në strategji, pasi ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë;
- + Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- + Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëtore)

